

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Kolegji Gjilani**

**Gjilan, Republika e Kosovës**

**5 qershor, 2014**

**NGA KOMITETI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Prof. Univ. Dr. Monika Petermandl, FHWien-Studiengänge der WKW, Vjenë**

**Prof. Univ. Dr. Ingeborg Mottl, Universiteti i Salzburgut**

**Autorizuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)**

## **PARATHËNIE**

Ky raport është rezultat i një procesi të shqyrtimi të jashtëm në Kolegjin Gjilani (në referencat e ardhshme KGJ), i cili është kryer në maj 2014, me një vizitë në terren më 6 maj, 2014.

Qëllimet e përcaktuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim përfshijnë ri-akreditimin institucional të kolegjit si dhe ri-akreditimin e tri programeve bachelor

- Banka, Financa dhe Kontabilitet (BA)
- Menaxhment (BA)
- E Drejta e Përgjithshme (LLB)

Recensentët Prof. Dr. Monika Petermandl, FH Wien der WKW (Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Odës Ekonomike të Vjenës, Austri,) dhe Prof. Dr. Ingeborg Mottl, Universität Salzburg (Universiteti i Salzburgut, Austri) do të donin të shprehnin mirënjohje të thellë për mirëpritje nga ana e Agjencisë së Kosovës për Akreditim Prof. Dr. Ferdije Zhushi-Etemi, Msc. Basri Muja, Znj. Furtuna Mehmeti dhe Z. Fisnik Gashi për besimin dhe përkrahjen e tyre profesionale. Recensentët do të donin të falënderonin menaxhmentin, personelin akademik dhe jo-akademik të KGJ për përgatitjen e raportit të Vetë-vlerësimit dhe vizitës në terren në Gjilan, të cilët i dhanë ekipit të ekspertëve shqyrtues (në referim në të ardhmen EE) mundësinë për të mbledhur më shumë informata nga menaxhmenti, personeli akademik dhe nga studentët dhe për të diskutuar në thellësi çështje thelbësore të zhvillimit të mëtejshëm të KGJ.

## **BAZA E INFORMACIONIT**

- Raporti i Vetëvlerësimit (në referencat e ardhshme RVV)
- Vizita në terren
- Informata shtesë të ofruara gjatë dhe pas vizitës në terren

## **MIRËNJOHJE PËR ZBATIM TË REKOMANDIMEVE**

EE i vlerëson përmirësimet në nivel institucional dhe organizativ të bëra që nga akreditimi i fundit i institucionit dhe programeve, të cilat janë bazuar në rekomandimet e raporteve të vlerësimit. Raporti i tanishëm do t'iu referohet këtyre përmirësimeve në kapitujt përkatës.

## **MIRËNJOHJE PËR KOMENTET E KGJ NË DRAFT RAPORTIN VLERËSUES**

EE dëshiron të falënderojë KGJ për komentet e tij pozitive dhe informatat shtesë në programin e drejtësisë, të cilat janë konsideruar nga EE në Raportin Përfundimtar të tij.

## 1. DEKLARATA E MISIONIT

Siç thuhet në misionin e KGJ (RVV, 2013): *"të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit të Gjilanit, Kosovës dhe më gjerë përmes përgatitjes së profesionistëve të mirë-arsimuar dhe të kualifikuar, krijimin e njoburive të reja dhe zbatimin e rezultateve të kërkimit përmes dialogut social dhe partneritetit akademik "*.

Ky formulim tingëllon shumë i përgjithësuar dhe nuk mund të japë udhëzime për vendime strategjike. Në mënyrë më konkrete përshkruan vizionin e deklaruar, atë që instituti vërtetë ka për qëllim: *"Të jetë një nga institucionet e arsimit të lartë më të mira në Kosovë për krijimin e mundësive profesionale nëpërmjet arsimit dhe në këtë mënyrë një burim krenarie për studentët tanë, personelin, dhe komunitetet të cilave ne iu shërbejmë. "*

KGJ ka nxjerrë disa qëllime konkrete strategjike nga misioni dhe vizioni i tij, siç janë:

- Lidhur me lëndët e studimit dhe studentët:

*për t'u përqëndruar në edukim në fushën e drejtësisë dhe ekonomisë*

*për të parë fokusin kryesor në rajonin gjeografik të Anamoravës dhe Luginës së Preshevës*

*kur merren vendime për numrin e studentëve, programeve të reja apo zgjerimin e aktiviteteve t'i jepet përparësi domosdoshmërisë së cilësisë*

- Në lidhje me kërkimin shkencor:

*nuk dëshiron që të bëhet një institucion i arsimit të lartë i udhëhequr nga kërkimi*

*hulumtimi duhet t'i drejtohet dhe të jetë i pranueshëm për botën e vërtetë dhe të ketë ndikim të dukshëm*

*të zhvillojë marrëdhënie me industrinë (lokale dhe rajonale) për të rritur konkurrencën tonë në të ardhmen*

- Në lidhje me metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

*të edukojë përmes mësimdhënies, praktikës dhe përvojës profesionale*

*t'i japë përparësi teknologjisë TIK dhe studimit në distancë*

Për EE ishte pozitive që të kuptojë se këto qëllime konkrete strategjike janë trajtuar në bisedën tonë me personelin menaxhues dhe se ato janë në mendjen e personave përgjegjës. Një prototip i një platforme TIK për të mësuarit në distancë i është demonstruar EE-së.

Në anën tjetër, shumë qëllime tjera strategjike dhe synime janë formuluar në RVV. Ekziston përshtypja se KGJ e di se ka një rrugë të gjatë për të bërë për të arritur vizionin e tij për të qenë një nga institucionet më të respektuara të arsimit të lartë në Kosovë. Ka ende mangësi në lidhje me hulumtimet e aplikuara me ndikim të gjerë ose ndërkombëtarizim (të personelit, studentëve dhe hulumtimit) ose për të pasur në mënyrë të qëndrueshme një personel të shkëlqyer akademik me orar të plotë pune.

Rekomandohet përcaktimi i qëllimeve jo të shumta por strategjike konkrete dhe të matshme, të cilat duhet të arrihen gjatë në një, dy ose tri viteve të ardhshme.

*R.1.1: Formulo për 3 vitet e ardhshme qëllime strategjike konkrete dhe të matshme të cilat duhet të arrihen. Planifiko si të vlerësosh rezultatet.*

*R1.2: Shpërndaj këto qëllime të parashikuara brenda kolegjit tënd (personelit)*

*R1.3: Vlerëso shpesh imazhin e kolegjit tuaj vis-à-vis grupeve tuaja të interesit (studentëve, ish-studentëve, industrisë, publike).*

## **2. ORGANIZIMI (LIRIA AKADEMIKE), MENAXHIMI DHE PLANIFIKIMI**

Struktura organizative e KGJ është vlerësuar si e qartë dhe e dobishme. Janë ndërmarrë disa përmirësime në bazë të rekomandimeve të ekipit shqyrtues, i cili vizitoi KGJ në vitin 2011.

Bordi Drejtues është ristrukturuar dhe tani përbëhet nga 7 anëtarë, 2 prej të cilëve janë zgjedhur nga themeluesit, 3 anëtarë janë emëruar nga Këshilli Akademik, 1 anëtar nga Departamenti i Kërkimeve dhe 1 anëtar është emëruar nga Unioni i Studentëve, duke garantuar kështu një balancë të përshtatshme ndërmjet interesave akademike dhe interesave të themeluesve.

Video-kamerat janë larguar nga dhomat e mësimit dhe zyrat në mënyrë që të ruhet liria akademike dhe privatësia e studentëve, personelit akademik dhe atij administrativ.

Proceset vendimmarrëse janë përshkruar dhe tregojnë kufinj të qartë në mes vendimeve për çështjet akademike dhe çështjet e përgjithshme menaxheriale. Janë përcaktuar përgjegjësitë e secilit organ të strukturës organizative.

Personeli menaxhues i KGJ pranon se për ta zhvillimi i cilësisë është më i rëndësishëm se sa rritja. Kështu në të ardhmen më shumë theks do të vihet në zhvillimin e metodave të reja dhe efektive të mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe veprimtarisë kërkimore. Ata janë të vetëdijshëm për mangësitë në fushën e kërkimit, të cilat ata i konsiderojnë si të lidhura me mungesën e fondeve kërkimore. Është përmendur në RVV se një strategji komercializimi e hulumtimeve dhe shërbimeve për industrinë mund të jetë një mënyrë për të fituar më shumë mjete për financimin e kërkimit.

*R2.1: Sa iu përket mjeteve financiare për kërkime, EE rekomandon adresimin tek industria në rajon dhe ofrimin e konsultimeve dhe analizave të bazuara në kërkime për të përmirësuar pozicionin në treg të kompanive.*

### **PROGRAMET AKADEMIKE**

Prej programit të plotë të studimit të ofruar nga KGJ, në këtë kohë do të riakreditohen 3 Programe Bachelor. Prandaj, vetëm këto programe janë vlerësuar nga EE.

#### **Programi Akademik: Bachelor në Banka, Financa dhe Kontabilitet (BA)**

Të gjeturat dhe rekomandimet në vijim janë bazuar në RVV, Vizitën në Terren të Ekspertëve të Jashtëm të cilët kanë vlerësuar programet në fushën e ekonomisë dhe biznesit, në takimin me përfaqësuesit përgjegjës të KGJ (më 6 maj 2014) dhe në dokumentet e dorëzuara pas vizitës me kërkesë të EE.

Programi Bachelor është një program studimi universitar tre-vjeçar, i cili ofron hyrje në ekonomi dhe biznes me specializim në Banka, Financa dhe Kontabilitet. Ai është i lidhur ngushtë me Programin Bachelor në Menaxhment, me kurrikulë identike me atë të vitit të parë të studimeve (semestrat 1 dhe 2).

Kjo iu jep mundësi studentëve, të cilët nuk kanë njohuri për ekonomi dhe administrim biznesi në fillim të studimeve të tyre, që të marrin vendimin e tyre drejt specializimit pasi të kenë fituar njohuri themelore dhe të rëndësishme.

KGJ ka filluar me këtë program në vitin akademik 2006/2007. Numri i studentëve që regjistrohen gjatë viteve ka ndryshuar, duke qenë rreth dyzet në dy vitet e fundit. Megjithatë, ky është një numër i mjaftueshëm i studentëve duke pasur parasysh mundësitë e kufizuara të punësimit në këtë sektor dhe rajon. Në vitet 2011-2013 ky program ka pasur 61 të diplomuar (33 meshkuj, 28 femra).

Programi korrespondon me deklaratën e misionit (të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit) dhe qëllimet strategjike të KGJ (pasi që qëllimi është formuluar për të arsimuar studentë në fushën e drejtësisë dhe të ekonomisë).

Kurrikula bën dallim mes lëndëve obligative dhe atyre zgjedhore (1 lëndë zgjedhore në vitin e parë, 2 lëndë zgjedhore nga semestri III deri në të V dhe 1 zgjedhore në semestrin VI). Përderisa lëndët obligative mbulojnë thelbin e diturisë, shkathtësive dhe kompetencave të fushës profesionale, lëndët zgjedhore iu mundësojnë studentëve të zgjerojnë aftësitë e tyre në fusha përkatëse (si sociologji, ekonomi, menaxhim i burimeve njerëzore, ndërmarrësi, financa publike, etikë). Kështu studentët mund formësojnë profilin e kompetencave individuale dhe të rrisin mundësitë e tyre për punësim. Disa nga lëndët zgjedhore gjithashtu iu mundësojnë studentëve që të eliminojnë mangësitë që ata kanë në fushat e kompetencave kryesore (si informatikë ose matematikë).

Rekomandimet e rëndësishme të cilat ekipi i ka bërë në vitin 2011 janë zbatuar:

- Shkrimi akademik është bërë lëndë obligative në semestrin V
- Teza Bachelor, e cila duhet të përpunohet në kombinim me stazhin, është ngritur në 8 ECTS
- 1 ECTS tani është e barabartë me 25 orë punë

Në përgjithësi mund të thuhet se kurrikula është e ekuilibruar dhe i plotëson standardet evropiane të programeve krahasuese të studimit.

EE fitoi përshtypjen se konceptet didaktike luajnë një rol vendimtar në KGJ. Është përmendur në RVV që KGJ miraton metodat aktive dhe praktikën e mësimdhënies dhe të mësuarit. Për shkak të grupeve të vogla është e mundur që të sigurohen procese efektive të mësimit. Duhet përmendur se shumë vëmendje i është kushtuar metodave të të mësuarit të bazuar në IT. Kolegji ka zhvilluar platformën e vet të të mësuarit elektronik, e cila lejon jo vetëm shkarkimin e materialit mësimor por edhe komunikimin me profesorë dhe mund të jenë në mesin e studentëve. Komunikimi në distancë është i rëndësishëm, ngase profesorët të cilët punojnë me gjysmë orari nuk janë gjithmonë në dispozicion të studentëve.

Megjithatë, duket se ende ka nevojë për zhvillim sistematik të profesorëve në metoda të reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Parakusht do të jetë që personeli akademik të ketë një angazhim të lartë për të mbështetur cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në KGJ (në përputhje me vizionin "që të jetë një nga institucionet më të respektuara të arsimit të lartë në Kosovë"). Kjo do të thotë të jenë të përgatitur për të shpenzuar kohë për trajnimin e mësimdhënësve dhe shkëmbimin e përvojës didaktike.

Kjo në një shkallë të lartë varet nga metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies që studentët të kenë mundësi dhe kërkesë për studim të pavarur, reflektim dhe analizë.

Natyrisht duhet pasur parasysh ngarkesa e përgjithshme e studentëve. Ka zakonisht disa paqartësi se sa orë duhet të kalojnë studentët duke studiuar. EE rekomandon që studentëve t'iu kërkohej që të mbajnë një "ditar studimi" i cili iu mundëson atyre të reflektojnë çfarë të dhëna ata kanë marrë dhe çfarë kanë mësuar.

Programet Bachelor janë hapi i parë drejt punës akademike. Prandaj, kërkesat për cilësi të tezës bachelor luajnë një rol të rëndësishëm. EE kishte mundësinë që t'i hidhte një vështrim disave nga tezat Bachelor. U krijua përshtypja se ato dallonin në cilësi. Rekomandohet përcaktimi i standardeve të cilësisë minimale për një tezë Bachelor: p.sh. përcaktimi i vëllimit të faqeve, sasia dhe cilësia e burimeve shkencore, metodat kërkimore të përdorura, strukturë e qartë dhe koherencë e tezës.

*R3.1: Promovo në mënyrë më sistematike kompetencat didaktike të personelit mësimdhënës duke implementuar program për zhvillim didaktik*

*R3.2 Inkurajo studentët që të mbajnë një ditar studimi dhe diskuto shpesh me ta ngarkesën e punës*

*R3.3 Defino standardet minimale për Tezën Bachelor*

### **Programi Akademik: Menaxhment (BA)**

Të gjeturat dhe rekomandimet në vijim janë të bazuara në RVV, Vizitën në Terren të ekspertëve të jashtëm, të cilët kanë vlerësuar programet në fushën e ekonomisë dhe biznesit, takimin me përfaqësues përgjegjës të KGJ (më 6 maj, 2014), dhe në dokumentet e dorëzuara pas vizitës me kërkesë të EE.

Programi Bachelor është një program studimi universitar tre-vjeçar, i cili ofron një hyrje në ekonomi dhe biznes me specializim për Menaxhment. Ai është i lidhur ngushtë me Programin Bachelor në Banka, Financa dhe Kontabilitet, me kurrikulë identike me atë të vitit të parë të studimeve (semestrat 1 dhe 2).

Prandaj, shumica e vërejtjeve të cilat unë i kam bërë në lidhje me Bachelor në Banka, Financa dhe Kontabilitet vlejnjë gjithashtu edhe për Bachelor në Menaxhment.

Lidhja e ngushtë midis dy programeve vlerësohet si e dobishme. Siç u përmend më lart, paralelizmi i lëndëve përkatëse në vitin e parë të studimeve është një përparësi, e cila iu mundëson studentëve të cilët nuk kanë njohuri për ekonomi dhe administrim biznesi në fillim të studimeve të tyre, të marrin vendimin e tyre lidhur me specializim pasi që të kenë fituar njohuri themelore dhe relevante.

KGJ ka filluar me këtë program në vitin akademik 2006/2007. Numrit i studentëve të regjistruar është ngritur deri në 60 në vitin 2009/2010, pastaj gjatë viteve 2010/2011 dhe 2011/2012 ka rënë në 44. 2012/2013 ka qenë viti më i mirë deri më tani me 115 regjistrime. Në vitin 2013/2014 janë regjistruar 88 studentë në këtë program. Nga 2011 deri më 2013 kanë diplomuar 38 studentë (22 meshkuj, 16 femra). Kjo është një

përçindje pak e ulët e studentëve të regjistruar. Arsyet duhet analizuar. Megjithatë, supozohet se programi Bachelor në Menaxhment ka një potencial të mirë për të qenë i suksesshëm. Kjo dëshmohet nga një numër i mjaftueshëm i regjistrimeve gjatë 2 viteve të fundit. Po ashtu fakti që studentët mund të vazhdojnë studimet e tyre përkatëse në Programin Master të GJK duhet të jetë një nxitje për ata që mbarojnë shkollën e mesme të regjistruan në këtë program Bachelor.

Programi korrespondon me deklaratën e misionit (për të njëjtat arsye që janë përmendur më lartë për programin Bachelor në Banka, Financa dhe Kontabilitet). Ai siguron një arsim të përgjithshëm në administratën e Biznesit, e cila është e rëndësishme në çdo degë të biznesit. Në theks është fokusi për Menaxhimin e NVM-ve dhe Ndërmarrësi në semestrin IV. Të diplomuarit mund të nxiten të punojnë në kompani familjare ose edhe të fillojnë biznesin e tyre, që të dyja këto të rëndësishme për rajonin.

Kurrikula dallon mes lëndëve obligative dhe atyre zgjedhore (1 lëndë zgjedhore në vitin e parë, 2 lëndë zgjedhore nga semestri III deri te semestri V, dhe 1 zgjedhore në semestrin VI).

Lëndët obligative të vitit të parë (të njëjta me ato të vitit të parë të Bachelor në Banka, Financa dhe Kontabilitet) ofrojnë teori dhe aftësi themelore të çdo programi studimi të ekonomisë dhe biznesit: Mikroekonomia, Makroekonomia, e Drejta e Biznesit, Kontabiliteti, Matematika dhe Statistika, si dhe Gjuha Angleze. Viti 2 përfshin lëndët kryesore të administrimit të biznesit: Menaxhment, Marketing, Menaxhim i Burimeve Njerëzore, Menaxhim i Cilësisë dhe fokusi i lartpërmendur në menaxhimin e NVM-ve dhe Ndërmarrësi. Viti 3-të përqendrohet në kompetencat qendrore drejtuese: Menaxhimi Strategjik, Menaxhim i Projektit, Liderhip, Vendimmarrje në Biznes, dhe Menaxhment Operativ. Shkrimi akademik gjithashtu përfshihet si përgatitje për Tezën Bachelor.

Lëndët zgjedhore iu mundësojnë studentëve të zgjerojnë aftësitë e tyre në fusha përkatëse (si sociologji, psikologji e punës, ekonomi e burimeve, çështje të biznesit evropian dhe ndërkombëtar). Kështu, studentët mund të formësojnë profilin e kompetencave të tyre individuale dhe rrisin mundësitë e tyre për punësim. Disa nga lëndët zgjedhore gjithashtu iu mundësojnë studentëve të eliminojnë mangësitë që ata kanë në fushat kryesore të kompetencave (si informatikë ose matematikë).

Siç është përmendur edhe më lart, janë zbatuar rekomandime të rëndësishme të cilat ekipi shqyrtues i ka bërë në vitin 2011:

- Shkrimi akademik është bërë lëndë obligative në semestrin V
- Teza Bachelor, e cila duhet të përpunohet në kombinim me stazhin, është ngritur në 8 ECTS
- 1 ECTS tani është e barabartë me 25 orë punë.

Në përgjithësi, mund të thuhet se kurrikula është e ekuilibruar dhe i plotëson standardet evropiane të programeve krahasuese të studimit.

Deklaratat të cilat janë bërë në lidhje me programin Bachelor në Banka, Financa dhe Kontabilitet janë të rëndësishme edhe për programin Bachelor në Menaxhment. Prandaj, këtu mund të referohen vërejtjet e mësipërme në lidhje me konceptet didaktike, trajnimin e mësimitdhënësve, studimet e pavarura, ngarkesën e punës, dhe kërkesat e tezës bachelor.

*R4.1: Vështro nivelin e braktisjes së studentëve, analizo arsyet dhe ndërmerr masat e duhura.*

*R4.2: Promovo në mënyrë më sistematike kompetencat didaktike të personelit mësimitdhënës duke zbatuar një program zhvillimor didaktik.*

R4.3: *Inkurajo studentët që të mbajnë një ditar studimi dhe diskuto shpesh me ta ngarkesën e punës.*

R4.4: *Defino standardet minimale për Tezat Bachelor.*

### **Programi Akademic: Bachelor i Drejtësisë (LL.B.)**

Të gjeturat dhe rekomandimet në vijim janë rezultat i një Vizite-në-Terren të ekspertëve të jashtëm të cilët kanë përshkruar Programin Bachelor në Drejtësi në bazë të Raportit të Vetëvlerësimit- (RVV, f. 110-168) dhe takimit me përfaqësues të Kolegjit të Gjilanit më 6 maj, 2014 për të diskutuar aplikimin e tyre për riakreditim për programin në Gjilani.

Krahas kësaj, pas takimit Eksperti i Jashtëm ka kërkuar sigurimin e disa dokumenteve shtesë. Eksperti i Jashtëm i ka pranuar të gjitha dokumentet e kërkuara, duke përfshirë një pasqyrë të korrigjuar të Kurrikulës së studimit Bachelor i Drejtësisë (LL.B) me një përshkrim të modulit aktual.

Programi Bachelor E Drejta e Përgjithshme është një program studimi universitar katërvjeçar që çon drejt arsimit universitar në fushën e drejtësisë. Ai është i organizuar si program me orar të plotë dhe orar të shkurtuar me metoda të të mësuarit në distancë. Çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra, me 30 ECTS për secilin semestër dhe me gjithsej 240 ECTS. Semestri i fundit është për përgatitjen e Temës së Diplomës. Diploma akademike e ofruar është Bachelor i Arteve në Drejtësi (LL.B; RVV fq. 110). Është në dispozicion një përshkrim i kërkesave të pranimit dhe procedurave të përzgjedhjes. Llogaritja e ECTS-ve është shpjeguar në detaje (1 ECTS korrespondon me 25 orë punë të studentit, shih RVV fq. 115.) dhe korrespondon me Standardet Evropiane.

Numri i studentëve është rritur që nga viti 2006 siç vijon:

- Numri i studentëve të tanishëm është 123 persona (të rregulltë) dhe 25 persona (me korrespondencë), gjithsej 148 studentë dhe asnjë student në Programin Master i Drejtësisë (shih RVV fq. 176.).

- Pritjet lidhur me numrin e studentëve për vitet e ardhshme për Programin Bachelor i Drejtësisë janë në vitin akademik 2014/15 me gjithsej 100 deri në 110 studentë në vitin akademik 2016/17.

- Të diplomuar në vitet akademike 2011-2013 kanë qenë gjithsej 59 (me 32 të diplomuar meshkuj dhe 27 femra).

- Numri i përgjithshëm i studentëve të Programit Bachelor i Drejtësisë pothuajse është dyfishuar nga 44 persona në vitin 2006 në 84 persona në vitin 2013/14. Numri i vendeve të studimit është 150 në vit.

Kjo pasqyrë paraqet një zhvillim realist që i përshtatet institucionit. Kolegji synon të zgjerojë programet e tij akademike duke ofruar në kampusin në Gjilan një program Master të dytë (Master i Drejtësisë me diplomë akademike LL.M).

Programi Bachelor në Drejtësi e Përgjithshme është një program i akredituar. Programi i studimit është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë të Kosovës, Statutin e Kolegjit Gjilani dhe konventave të Deklaratës së Sorbonës, miratuar më 25 maj 1998 për Zhvillim dhe Ekuivalencën e Arsimit të Lartë në Evropë, dhe me Deklaratën e Bolonjës, e datës 19 qershor 1999 me Përcaktimin e modeleve të Institucioneve Universitare në Evropë (shih RVV, faqe 112). Programi është i bazuar në programe të ngjashme të fakulteteve të ngjashme në universitetet evropiane dhe rajonale (si në Slloveni, Kroaci, Shqipëri, Turqi, Maqedoni ose Lituan) dhe për këtë arsye është i krahasueshëm me standardet ndërkombëtare.

Në bazë të dokumenteve në dispozicion dhe diskutimeve me menaxhmentin e Kolegjit Gjilani, EEJ është i bindur se Programi i Drejtësisë i propozuar është një program studimi klasik. Objektet dhe mundësitë janë ri-



dizajnuar pas vizitës në institucion në vitin 2012 në bazë të diskutimit në mes të EE dhe personave përgjegjës për programin. Ai kualifikon studentë për të gjitha llojet e profesioneve ligjore dhe ofron njohuri të cilat i duhen një të diplomuarit universitar në drejtësi për karrierë në drejtësi, ekonomi, jo-ekonomi ose administratë shtetërore. Gjithashtu është e mundur të vazhdohet me një Program Master në Drejtësi në nivelin akademik Master në Drejtësi (LL.M), i cili duhet të themelohet në të ardhmen.

Aktualisht ka vetëm dy ofrues të tjerë të arsimit të lartë në rajonin e Gjilanit (Universiteti i Prishtinës-Gjilan dhe Fama-Gjilan). Pra, programi i ofruar i plotëson nevojat e studentëve të tanishëm dhe atyre të ardhshëm, si dhe të tregut të punës ngase garanton çmime të përballueshme për shkollim, personel akademik të kualifikuar, infrastrukturë moderne për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Kjo është arsyeja pse një numër i madh i të diplomuarve janë të punësuar nga kompanitë kombëtare.

### **Komente mbi pyetjet e veçanta të vlerësimit të Programeve Akademike:**

Siç theksohet në RVV (fq. 113) qëllimi i Programit në Drejtësi është që t'iu japë studentëve njohuri të përgjithshme juridike, që i mundësojnë të diplomuarit të ndjek një specializim të mëtejshëm dhe në përputhje me specifikimet e deklaratës së misionit të Kolegjit Gjilani. Studentët marrin njohuri për sistemin aktual të drejtësisë së Kosovë, përkatëse dhe praktike për t'iu mundësuar atyre zhvillimin e mënyrës kritike të të menduarit dhe të kuptuarit të çështjeve ligjore. Krahas kësaj, të diplomuarit kanë aftësi të adaptueshme ndaj kërkesave të tregut dhe do të jenë në gjendje të vazhdojnë studimet pasuniversitare duke zotëruar komunikim të avancuar dhe aftësi analitike, si dhe njohuri të gjuhëve të huaja (RVV fq.113).

Kurrikula e Programit të Drejtësisë është e rregulluar me misionin e Kolegjit Gjilani për të fituar njohuri themelore për drejtësi (RVV fq. 112 + fq. 113). Rezultatet e Mësimnxënies janë të përshkruara dhe të kuptueshme (RVV fq. 114 + 115); prandaj RVV përfshin një pasqyrë të detajuar të "njohurive dhe të të kuptuarit", "aftësive njohëse", "aftësive praktike dhe profesionale" dhe "aftësive të transferueshme dhe kryesore". Kriteret e pranimit (regjistrimi i studentëve) janë të përcaktuara qartë në RVV (fq. 116) dhe ato i përmbushin standardet e kërkuara.

Krahas këtyre fakteve të dhënat për punën praktike (stazh) janë përfshirë në RVV (fq. 116). Stazhi është përmbushur në bashkëpunim me institucionin dhe organizatat dhe institucionet lokale në bazë të një plani të veçantë nën mbikëqyrjen e një këshilltari për çështje të punës praktike.

Ndërkohë, është krijuar një zbatim i veçantë strategjik i punës kërkimore me tema kërkimore në fushën e ekonomisë.

#### *R5.1 Plani kërkimor strategjik duhet të përfshijë gjithashtu më shumë çështje dhe tema ligjore në të ardhmen*

Studentët do të fitojnë njohuri në fushat kryesore ligjore, si Bazat e së Drejtës dhe Historia, E Drejta Kushtetuese, E Drejta Civile, E Drejta Komerciale, E Drejta Penale, E Drejta Administrative, E Drejta Ndërkombëtare dhe E Drejta Evropiane.

- Viti i parë, i cili është hyrje në studimin e së drejtës, do të bazohet kryesisht në lëndët të cilat ofrojnë njohuri themelore në lidhje me të drejtën, zhvillimin e saj, dhe elementet më të rëndësishme dhe lidhshmërinë e saj me fenomene të tjera shoqërore (detajet e kurrikulës janë theksuar në RVV fq.117-168)

- Mbi këtë bazë, në dy vitet e ardhshme studentët do të fitojnë njohuri të tjera në fushën e shkencave juridike, të nevojshme për punën e tyre siç është e cekur më poshtë ose për vazhdimin e studimeve në nivelin pas-universitar.

- Në vitin e fundit të studimeve theksi do të vihet në përmbajtjen opsionale dhe ata mund të zgjedhin midis tri lëmive (E Drejta Administrative-Kushtetuese, E Drejta Penale, dhe E Drejta Financiare, shih RVV fq. 119 + 120.). Dhe në semestrin e dytë të vitit të katërt studentët kanë kohë që të përgatisin tezën e diplomës dhe gjithashtu është siguruar një stazh (në total me 8 ECTS).

*Ekspert i Jashtëm sugjeron këtë rekomandime:*

R5.2: **Sasia e ECTS** të lëvizuë në mes të 5 dhe 7 ECTS për një lëndë. Eksperti i Jashtëm sugjeron reduktimin e sasisë së ECTS në rast të lëndëve tradicionale dhe më pak aktuale (p.sh. E Drejta Romake, Historia e i të Drejtës) dhe integrim të lëndëve më aktuale si "E Drejta e Pronësisë Intelektuale", "Aspekte Gjinore të së Drejtës", "Mbrojtja e të Drejtës së Konsumatorit", "E Drejta e Medias", "E Drejta Online"ose"E Drejta E-Commerce".

R5.3: Lëndë të gjubës angleze ofrohen në dy vitet e para të programit të studimit. Eksperti i Jashtëm sugjeron mbajtjen e lëndëve specifike (p.sh. E Drejta e BE ose E Drejta Ndërkombëtare Private) në gjubë të huaja si anglisht apo gjubë të tjera të Ballkanit.

R5.4: Gjendja e Personelit është një çështje shumë e rëndësishme në procesin e akreditimit. RVV ofron informacion në lidhje me personelin meshkaj dhe femra, si dhe për personelin me orar të plotë dhe ata me gjysmë orari (shih RVV faqe 169-175). Janë integruar informata lidhur me profesorët vizitues dhe aktivitetet kërkimore. CV-të e personelit akademik janë bashkëngjitur në versionin elektronik (shih RVV fq. 173). Personeli i përhershëm shkencor përbëhet nga 3 punonjës me PhD-Diplomë ose Diplomë Doktorature, dhe gjashtë punonjës me diplomë akademike të nivelit Master (RVV faqe 111).

Për të garantuar cilësinë e personelit në të ardhmen, Eksperti i Jashtëm sugjeron që në programet kërkimore të përfshihen më shumë mundësi të veçanta për anëtarët e personelit dhe t'u ofrohen atyre më shumë trajnime/kurse në metodat e hulumtimit dhe kohë për kërkime më pastaj në praktikë.

Krahbas problemit anëtarët e personelit duhet gjithashtu të jenë në gjendje të kenë më shumë programe të brendshme në metodat moderne dhe dhe kreative të mësimdhënies.

Për arritje të standardit akademik Evropian është gjithashtu e nevojshme që të rritet numri i personelit femra sa më shpejt që të jetë e mundur.

Kapacitetet e gjubës duhet të jenë pjesë e procesit të përzgjedhjes për anëtarë të rinj të personelit.

R5.5: Programi mësimor përfshin përshkrim të lëndës, qëllimet dhe rezultatet e mësimit (me një përkufizim të njohurive, aftësive dhe kompetencave), metoda të mësimdhënies dhe mësimit, metoda të vlerësimit dhe kritere të kalimit, mjete të konkretizimit, informata për lidhshmërinë mes pjesës teorike dhe praktike të mësimdhënies dhe literaturës. Informata rreth literaturës duhet të bëjnë dallimin ndërmjet punimeve të detyrueshme dhe atyre të rekomanduara.

R5.6: Ekspert i Jashtëm sugjeron zgjerimin e mundësive të **bibliotekës** dhe ofrimin e më shumë librave dhe baza të të dhënave ndërkombëtare si për studentët ashtu edhe për personelin. Ky rekomandim përfshin organizimin e librave të reja të drejtësisë për biblioteka, si dhe mundësi të reja për përdorimin e bazave të të dhënave ligjore ndërkombëtare dhe evropiane si Lexis-lajme. Një program aktual për identifikim të plagjiaturës duhet të përdoret për verifikimin e të gjitha punimeve shkencore të paraqitura.

R5.7: Duhet të implementohen mundësi bashkëkohore të **Studimit në Distançë** për të ofruar mundësi për pjesëmarrje në kuadër të zhvillimit ndërkombëtar të së drejtës dhe për të bashkëpunuar me studentët e huaj dhe institucionet në një mënyrë më të mjaftueshme.

R5.8: **Struktura e programit dhe mundësitë** si të përshkruara në RVV janë të mjaftueshme për momentin. Programi Bachelor duhet të forcobet për të siguruar se i mbulon nevojat dhe mundësitë e NVM-ve lokale dhe zhvillimin e shoqërisë.

#### 4. STUDENTËT DHE MENAXHMENTI I STUDENTËVE

Numri aktual i studentëve është në total 482 në vitin akademik 2013/14 (RVV fq 176). Brenda RVV janë integruar listat e detajuara me figura të rëndësishme të situatës së studentëve (RVV fq. 176-179), numri i

përitshëm i studentëve për vitet e ardhshme për institucionin dhe për secilin me planin aktual të zhvillimit. Megjithatë, domosdoshmëria e zhvillimit të vazhdueshëm të studentëve ishte e qartë për Ekspertët e Jashtëm gjatë takimit me studentët.

### **Rekomandimet e ish-Ekspertëve të Jashtëm janë zbatuar si në vijim:**

- Kolegji Gjilani ka ndërmarrë hapa konkretë drejt përmirësimit të normave të avancimit duke promovuar programet e tyre studimore dhe cilësinë akademike për rritjen e numrit të studentëve të rinj (RVV, fq. 207).

- Në bazë të propozimit të ish-Ekipit të Ekspertëve të Jashtëm, e tërë kurrikula e Bachelor tani ofron 1 ECTS për 25 orë punë (RVV, fq. 207).

Siç theksohet në RVV (fq. 178), Kolegji Gjilani i kushton një rëndësi të madhe ndarjes së bursave për studentët. Në këtë aspekt institucioni ka krijuar zyren për zhvillim dhe bashkëpunim dhe zyrën për zhvillim të karrierës për të zhvilluar një politikë shumë aktive në informimin e studentëve për mundësitë e bursave në institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare. Si rezultat i këtyre përpjekjeve, 12 studentë tashmë kanë marrë bursa nga institucione vendore dhe ato ndërkombëtare. Janë zhvilluar politika për të mundësuar përfaqësimin e studentëve në të gjitha organet akademike dhe organizative të Kolegjit Gjilani (RVV, fq. 178)

- Studentët kanë pjesëmarrje të plotë në organin kryesor drejtues të institucionit (p.sh. Këshilli Drejtues, Këshilli Akademik, Këshillat e Departamentit të Studimeve, Komisionet Disciplinore dhe Etike, Komisioni për Sigurim të Cilësisë).

- Studentët mund të zgjedhin organin e tyre përfaqësues ("Parlamenti i Studentëve"), duke ofruar një kontribut të madh në zhvillimin akademik.

- Studentët gjithashtu kanë krijuar klube të ndryshme studentore si "Klubi i Juristëve të Rinj ", "Klubi i Ekonomisë", "Klubi i Futbollit ", "Klubi i të Rinjve për Kërkime IT ".

- Studentët gjithashtu kanë revistën e studentëve "Studenti", e cila botohet dy herë brenda vitit akademik.

Në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion përshtypja kryesore e Ekspertëve të Jashtëm ishte besnikëria e madhe ndaj institucionit të tyre. Ata duket të jenë shumë me fat dhe t'i vlerësojnë shumë mundësitë e tyre për studim.

Përparësitë kryesore për studentët janë:

- Programet janë praktike dhe të zbatuara
- Qasja në personelin akademik është relativisht e lehtë
- Mbështetja IT është e kënaqshme
- Vlerësohen lektorët e ftuar

Pra, studentët informuan Ekspertin e Jashtëm se në përgjithësi nuk ka probleme serioze që duhet zgjidhur. Krahas kësaj, ka pasur dëshira lidhur me ofertën për të studiuar një semestër jashtë vendit (me bartje të plotë dhe njohje të krediteve të fituara në këtë mënyrë), ose të paktën vizita më të organizuara studimore dhe shkëmbime jo vetëm për individët, por edhe për grupe më të mëdha nga institucione të veçanta.

## 5. HULUMTIMI

KGJ pranon se niveli i veprimtarisë kërkimore ka qenë i ulët. Megjithatë, kohëve të fundit ka pasur disa nisma të mëdha të cilat kanë ndihmuar në arritjen e një progresi të caktuar në fushën e huumtimeve. Njëra nga to është krijimi i Qendrës për Kërkime dhe Transfer Njohurish, në të cilin janë grumbulluar hulumtimet e kryera nga stafi akademik si dhe studentët, të cilët kanë punuar Tezat Bachelor Master.

Shumë nga aktivitetet kërkimore kanë karakterin e kërkimit të aplikuar në bashkëpunim me organizatat të cilat përfitojnë nga rezultatet e kërkimit. Në veçanti duket se tezat bachelor të studentëve iu drejtohen përfitimeve të organizatave pasi ata janë të inkuadruara në stazh.

EE inkurajon KGJ që të vazhdojë në këtë mënyrë ngase studentët mund të mësojnë shumë nga bashkëpunimi me organizata/biznese. Atyre iu ofrohet mundësia për të punuar me "klientë të vërtetë" të cilët kanë kërkesa reale, gjë që e bën bashkëpunimin sfidues për studentët. Kjo gjithashtu mund të jetë hapi i tyre i parë drejt punësimit pasi të diplomojnë.

Duhet theksuar se KGJ aktualisht ka ndarë 10 përqind të të ardhurave të tij për kërkime dhe projekte të kryera nga personeli. Në këtë aspekt KGJ është në rrugë të mirë.

Hulumtimi është gjithashtu i dukshëm në botime. Siç është përmendur në RVV, janë botuar 4 tituj universitarë, 6 monografi dhe 2 raporte të veçanta kërkimore shkencore. KGJ gjithashtu boton revistën e vet shkencore "Norma". Një shembull i botimit i është prezantuar EE.

Pjesëmarrja e personelit të brendshëm akademik është duke u rritur vazhdimisht. Në vitin 2012/13 8 anëtarë të personelit kanë marrë pjesë në Konferenca Shkencore, 7 në Simpoziume Shkencore, dhe 5 në Seminare Shkencore (nuk përmendet nëse ato kanë qenë në nivel kombëtar apo ndërkombëtar.)

Shumë bashkëpunime në organizata relevante, universitete dhe kompani janë të shënuara në RVV. (Shih më shumë në kapitullin pasues "Bashkëpunimi Ndërkombëtar).

Gjëja kryesor lidhur me përmbajtjen kërkimore është se KGJ po planifikon të krijojë një numër grupesh kërkimore.

Tashmë janë formuluar disa parime të cilat mund të rrjedhin në një strategji kërkimore. EE inkurajon menaxhmentin që të përcaktojë disa qëllime strategjike konkrete dhe të matshme për kërkime për tri vitet e ardhshme dhe të vë theksin në arritjen e tyre.

*R6.1 Zbërillo një strategji mundshme kërkimore për KGJ për tri vitet e ardhshme. Kontrolllo arritjet.*

## 6. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Rekomandimet e ish-Ekspertëve të Jashtëm janë zbatuar si veprimtari ndërkombëtare dhe përfshirja e planit aktual të zhvillimit për personelin ka rezultuar në bashkëpunim me 12 universitete, institucione dhe organizata tjera vendore e ndërkombëtare në fushën e studimeve, kërkimeve apo projekteve të tjera. Këto marrëveshje

kanë të bëjnë p.sh. me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, Bibliotekën Universitare të Kosovës, Fakultetin Juridik, Bibliotekën Universitare të Prishtinës (RVV fq 206).

Krahas kësaj Kolegji Gjilani i ofron personelit mundësi të veçanta për të marrë pjesë në programet e bashkëpunimit ndërkombëtar ose kombëtar: Prandaj, normalisht institucioni do të mbështesë personelin me të gjitha shpenzimet e trajnimit në qoftë se kërkohet që një anëtar i personelit të financohet për shpenzimet e udhëtimit ose akomodimit në Kosovë dhe jashtë vendit.

Kolegji Gjilani do të kontribuojë gjithashtu në shpenzimet kur anëtari i personelit prezanton një punim në një konferencë në Kosovë apo jashtë vendit. Kolegji merr pjesë me 50 për qind të kostos në qoftë se personeli zgjedh të marrë pjesë në konferenca. Nëse një anëtar i personelit të dëshiron të regjistrohet një shkallë më të lartë që është me rëndësi për punën e tij ose zhvillimin profesional, Kolegji normalisht do të ndihmojë në financim në bazë vjetore, deri në vlerë maksimale prej 2.500 Euro. Theks i veçantë është vënë në mbështetjen pasuniversitare, kërkime dhe kualifikime profesionale ngase fakulteti dëshiron të rrisë shkathhtësitë dhe kualifikimet e personelit (RVV fq. 175)

Informatat në lidhje me përfshirjen e personelit akademik në konferenca, simpoziume, dhe seminare shkencore (RVV fq. 191), si dhe në projekte për bashkëpunim ndërkombëtar (RVV fq. 193) janë me të vërtetë mbresëlënëse. Aktualisht duket se këto bashkëpunime janë duke funksionuar.

*R7.1: Kolegji Gjilani duhet të vazhdojë të themelojë rrjetet e veta të marrëdhënieve të jashtme dhe shkëmbimeve, në veçanti në bazë të marrëdhënieve Erasmus dhe projekteve Tempus.*

## **7. PERSONELI**

Anëtarët aktualë të personelit janë të shënuar në mënyra të ndryshme, p.sh. profesorë me orar të plotë/të pjesshëm, profesorë të ftuar, fusha e hulumtimit dhe studimit, duke përfshirë edhe CV-të e tyre (RVV fq. 169-173). Gjatë takimit të Ekspertëve të Jashtëm me personelin ishte e dukshme domosdoshmëria e planit të vazhdueshëm të zhvillimit të personelit, edhe pse Kolegji Gjilani ka bërë përpjekje për të përmirësuar cilësinë e personelit të vet në vitet e fundit akademike (shih rezultatet e ish Shqyrtimeve të Jashtme dhe zbatimin e tyre).

### **Rekomandimet e ish-Ekspertëve të Jashtëm janë zbatuar si në vijim:**

- Video kamerat janë larguar nga sallat e ligjëratave dhe zyrat për të garantuar lirinë akademike dhe privatësinë e studentëve dhe të personelit (administrativ dhe akademik) (RVV fq 203.)

- Bordi Drejtues është ristrukturuar dhe tani përbëhet nga 7 anëtarë. Është zbatuar një sistem transparent për zgjedhjen e anëtarëve (RVV fq. 204).

- Në vitin e fundit Kolegji Gjilani ka ndërmarrë masa serioze për zbatimin e plotë të planit të zhvillimit të personelit (RVV fq 204):

o për të arritur metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies

o për të mundësuar pjesëmarrje në tri konferenca shkencore ndërkombëtare dhe dy seminare ndërkombëtare

o për të forcuar mobilitetin e personelit me dy Universitete të tjera të Ballkanit nga Shqipëria dhe Turqia

- Kolegji Gjilani ka rritur numrin e personelit akademik me 15 profesorë më shumë (me PhD-Diplomë), të cilët janë të punësuar kryesisht me orar të plotë (RVV fq 205.). Disa ligjërues shtesë pritet të marrin diplomën e doktoraturës brenda këtij viti akademik.

- Drejtuesit e programit në bashkëpunim me mësimdhënësit i kanë definuar objektivat e hulumtimit dhe mësimdhënies në lidhje me projekte specifike dhe kurse akademike të Kolegjit Gjilani.

- Krahas kësaj janë bërë investime për të ofruar më shumë zyra për personelin e brendshëm dhe Bordi Drejtues ka marrë një vendim për një buxhet për zhvillimin e personelit si një buxhet i përhershëm për çdo vit akademik.

- Janë përcaktuar kriteret për publikimin e punimeve akademike si dhe implikimet financiare të botimeve dhe aktiviteteve të tjera shkencore.

- Është zbatuar një plan specifik i zhvillimit për personelin akademik (RVV fq 174 + 175.) me strategjitë dhe politikat për ruajtjen e tanishme (akademike dhe profesionale) dhe politikat për tërheqjen e personelit të kualifikuar më mirë në kuadër të përmirësimit të përhershëm të Kolegjit Gjilani (RVV fq. 174). Plani i zhvillimit të personelit duhet të sigurojë politikën e zhvillimit të stafit për

o Barazi e çasjes së trajtimit të të gjithë personelit

o Përdorimi i talenteve specifike të secilit anëtar të personelit

o Zhvillimi i përvojës personale dhe profesionale individuale

o Angazhimi për burime dhe strategji të Kolegjit Gjilani.

- Numri aktual total prej 27 anëtarëve të personelit duhet të rritet në 43 anëtarë të personelit në vitin akademik 2016/17 (RVV fq 175.).

*R 8.1: Numri i anëtarëve të personelit duhet të rritet dhe të punësohen më shumë punonjës me orar të plotë. Dhe një pjesë të rëndësishme të personelit duhet t'i ofrohen mundësi të veçanta për të përmirësuar metodat e mësimdhënies dhe kërkimeve të tyre në kuadër të planit të zhvillimit institucional.*

*R 8.2: Të rritet cilësia e personelit: Personeli më i ri akademik duhet të integrohet duke ofruar zhvillim të personelit, trajnime në kolegji, përkrahje për kërkim dhe botim, si dhe mundësi për pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.*

*R 8.3: Krahas këtij problemi anëtarët e personelit duhet gjithashtu të jenë në gjendje të kenë më shumë programe në metodat moderne dhe kreative të mësimdhënies. Prandaj, në mënyrë të veçantë cilësia e personelit akademik dhe gjendja kërkimore në fakultet duhet të vlerësohet në mënyrë më të veçantë.*

## **8. FINANCAT DHE INFRASTRUKTURA/HAPËSIRA DHE PAJISJET**

Është përgatitur një Pasqyrë Financiare tre-vjeçare (për vitet 2014-2017). Bilanci i gjendjes i KGJ ka mbetur i qëndrueshëm gjatë gjithë viteve. Rezultatet financiare janë në përputhje me pritjet. Është e qartë se të ardhurat kryesore janë nga taksat shkollore. Këto janë rritur pak gjatë viteve dhe mbulojnë shpenzimet.

Një çështje e hapur është financimi i kërkimeve. Siç u përmend më parë, KGJ synon zhvillimin e një strategjie të komercializimit të kërkimeve dhe shërbimeve, në kërkim të granteve kërkimore nga BE dhe ato ndërkombëtare dhe tërheqjen e donacioneve të qeverisë dhe sektorit privat. Sa më shumë që performanca hulumtuese e KGJ konsiderohet si e vlefshme nga aktorë të ndryshëm, aq më shumë do të rritet mundësia për të arritur këto qëllime financiare.

*R 9.1 Thekso masat e mardhëdhënëve me publikun për të siguruar më shumë ndërgjegjësim për kërkimet në KGJ*

*R 9.2 Intensifiko bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar për t'u involvuar në projektet kërkimore të financuara*

KGJ disponon një ndërtesë të përshtatshme e cila ofron kushte adekuate për arsimin e lartë. Ka klasa të madhësive të ndryshme, secila me pajisje të lëvizshme dhe teknologji prezantimi. Duhet konsideruar sigurimi i më shumë klasëve me pajisje për konferencë për të mundësuar komunikim më të mirë midis studentëve dhe mësimitdhënësve. (Deri tani vetëm IT klasa ka pajisje për konferencë.) Gjithashtu mund të konsiderohet sigurimi i hapësirës për grupe të vogla punuese.

Biblioteka ka në dispozicion një numër të kufizuar të librave të shtypur. EE rekomandon që biblioteka të ofrojë drejtë libra (të shtypura) të cilat mbulojnë literaturën obligative për çdo lëndë. Letërsia angleze duhet të promovohet.

Pajisjet e IT janë të vjetra dhe ofrojnë qasje në një numër të bazave të të dhënave përkatëse (kryesisht shkencore) dhe në libra elektronike. Një përparësi e madhe pritët nga platforma e mësimitdhënies e cila është vetëm duke u testuar. Kjo ndër të tjera do të intensifikojë kontaktet midis studentëve dhe mësimitdhënësve me gjysmë orari.

Është për të përmendur se mësimitdhënësit me gjysmë orari nuk kanë zyra në ndërtesën e Kolegjit, ndërsa i tërë personeli me orar të plotë (administrativ apo akademik) kanë zyrën e tyre.

*R 10.1 Konsidero themelimin e më shumë klasave me pajisje për konferenca dhe ofrim të hapësirës për grupe të vogla, për të ofruar kushtet më të mira të metodave aktive dhe inovative të mësimitdhënies dhe mësimitdhënies*

*R 10.2: Garanto disponueshmëri të literaturës obligative (të shtypur) në bibliotekë.*

*R 10.3 Ofro hapësirë të mjaftueshme për profesorët me gjysmë orari*

## **9. MENAXHIMI I CILËSISË**

Sipas rekomandimeve të Ekspertëve të Jashtëm, organizimi i Departamentit të Menaxhimit të Cilësisë është ridizajnuar (RVV fq. 204). Parimet e sigurimit të cilësisë, të përvetësuara nga një institucion i arsimit të lartë janë realizuar në mësimitdhënie dhe mësimitdhënie si dhe përmes sigurimit të burimeve që ndihmojnë mësimitdhënien, mësimitdhënien dhe hulumtimin (RVV fq 180). Në mënyrë të veçantë, janë përfshirë masat e mëposhtme:

- parimet drejtojnë miratimin, monitorimin dhe rishikimin e programeve akademike.
- vlerësimi
- kualifikimet dhe kompetencat e personelit
- disponueshmëria e burimeve për të drejtuar programet
- dhënia e informacionit në lidhje me këto programe për të mundësuar menaxhim efektiv.

Këto parime janë të artikuluar në mënyrë të qartë dhe të kombinuara në mënyrë adekuate në një grup procedurash dhe politikash që janë në dispozicion për të gjithë anëtarët e personelit akademik e administrativ dhe studentëve.

Përshkrimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë është shumë i detajuar dhe përfshin rolin e Zyrtarit të Cilësisë, Këshillit Drejtues, Bordit Drejtues, dhe drejtuesve të programeve.

Rregulloret institucionale lidhur me procedurat për sigurimin e cilësisë së programeve janë të përcaktuara qartë dhe sigurojnë zhvillimin e mëtejshëm të strategjisë së Kolegjit Gjilani (RVV fq. 181 + 182).

Procedurat për shqyrtimin e programeve të studimit përfshijnë rregullore dhe manuale të sigurimit të cilësisë, rregulla për programet akademike, kode të praktikës së mirë, strategji të të mësuarit, mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe sigurim të cilësisë dhe politika editoriale në hulumtim (RVV fq 182 - 184).

Krahas kësaj, ka informata në lidhje me prezantimin e instrumenteve për vlerësimin e cilësisë së programit (RVV fq. 184 + 185), mjete për matjen e sigurimit të cilësisë dhe procedura të vazhdueshme për përmirësimin dhe shfrytëzimin e vlerësimeve të mëparshme (RVV f q. 185).

*R 11.13 Kolegji Gjilani ka bërë përpjekje të mëdha për themelimin e Menaxhmentit të Cilësisë brenda pjesëve të ndryshme të institucionit (programe studimi, çështje studentore, menaxhment dhe zhvillim të personelit.) Por vetëm një proces i vazhdueshëm vlerësues i këtyre aktiviteteve mund të sigurojë përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë brenda institucionit akademik në të ardhmen.*

## **PËRFUNDIM**

### **a. REKOMANDIM PËR RIAKREDITIM INSTITUCIONAL**

Lidhur me zhvillimin pozitiv të Kolegjit gjatë viteve të fundit, ekipi i ekspertëve rekomandon ri-akreditimin e Kolegjit Gjilani në Gjilan.

Ekipi i ekspertëve supozon se rekomandimet e formuluar në këtë raport janë marrë parasysh dhe zbatuar seriozisht.

### **b. REKOMANDIM PËR PËR RIAKREDITIM TË PROGRAMEVE STUDIMORE**

Ekipi i ekspertëve rekomandon ri-akreditimin e programeve bachelor në vijim:

- Bachelor në Banka, Financa dhe Kontabilitet (BA)
- Bachelor i Menaxhmentit (BA)
- Bachelor i Drejtësisë (LL.B)